



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:011930  
Datë: 07.02.2024  
Numri i dokumentit: 05297914

Ac.nr.6748/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Burim Shala, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.Z.Xh., M.H.B., dhe I.Xh., që të gjithë nga Lipjani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Q.R., avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensim i pagave mbi bazë të kualifikimit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.201/2020 të datës 05.09.2022, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 07.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Aprovohet e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.201/2020 i datës 05.09.2022, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.201/20 të datës 05.09.2022, në pikën I, të dispozitivit ka aprovuar në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve V.Z.Xh., M.H.B., dhe I.Xh., që të gjithë nga K. Lipjan. Në pikën dy, ka obliguar të paditurën Komuna e Lipjanit-Drejtoria e Arsimit, që paditësve të më poshtë shënuar t'ua paguaj kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe atë për: 1. V.Z.Xh., në emër të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguaj për 581 ditë pune shumë prej 1,162.00 euro, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 368.69 euro, në emër të kualifikimit shumë prej 3,074.44 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 881.34 euro, gjithsejtë

shumën 5,486.47 euro, dhe në llogari të trustit të kursimeve pensionale të paguhet shuma prej 360.00 si në llogari të Buxhetit të Kosovës në emër të tatimit në të ardhura të paguhet shuma prej 315.00 euro. 2. M.H.B., në emër të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguaj për 751 ditë pune shumën prej 1,502.00 euro, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 404.75 euro, në emër të kualifikimit shumën prej 2,271.15 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 651.07 euro, gjithsejtë shumën 4,828.97 euro, dhe në llogari të trustit të kursimeve pensionale të paguhet shuma prej 267.30 si në llogari të Buxhetit të Kosovës në emër të tatimit në të ardhura të paguhet shuma prej 253.75 euro. 3. I.Xh., në emër të shpërblimit jubilar i takon 50% i një page bazë në shumën prej 195.17 euro, me kamatë ligjore nga dt.07.03.2022-31.08.2022 në shumë prej 7.57 euro, në emër të shpenzimeve të ushqimit t'ia paguaj për 590 ditë pune shumën prej 1,180.00 euro, me kamatë ligjore 8% duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 385.49 euro, në emër të kualifikimit shumën prej 2,112.30 euro, me kamatë ligjore duke filluar nga dt.18.04.2017-31.08.2022, në shumë prej 605.53 euro, gjithsejtë shumën 4,486.06 euro, dhe në llogari të trustit të kursimeve pensionale të paguhet shuma prej 269.46 euro, si në llogari të Buxhetit të Kosovës në emër të tatimit në të ardhura të paguhet shuma prej 240.15 euro. Në pikën tre, ka detyruar të paditurën që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 2,188.8 euro, në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, dhe ka refuzuar pjesën tjetër të shpenzimeve si të pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje apo të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësve duke kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e të paditurës dhe të vërtetoj aktgjykimin e goditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 29.01.2020, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kompensim i pagave mbi bazë të kualifikimit, të precizuar si në parashtrësën e datës 05.08.2022, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t'iu paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar me kamatë prej 8 % vjetore, kamatën në vonesë si dhe t'ia paguaj

shpenzime e procedurës, në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të gjitha nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqës si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.201/20 të datës 05.09.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1, të LPK-së, lidhur me nenin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe vërtetim të gabuar të dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike pasi që nuk e ka vërtetuar fare faktin nëse paditëses së parë i takon kompensimi i pagave mbi bazë të kualifikimit, pasi që e njëjta në bazë të kontratës së punës ka krijuar marrëdhënie të punës si psikologe ndërsa sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33, të datës 29.08.2008, në pikën 1 ka përcaktuar që: *“Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa në pikën katër ka përcaktuar që: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë ) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktin nëse paditësja V.Z.Xh., sipas pikës 1 të këtij vendimi është e licencuar, në atë mënyrë që të mund të përfitojë ngritje të pagës bazë. Për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë u deshtë që të prishet në tërësi dhe lënda të kthehet në rivendosje, ngase gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur mundësi që të njëjtin eventualisht ta ndryshoj pasi që në bazë të provave nuk ka mundur që ta vlerësoj nëse paditësja e parë është e licencuar si dhe të vërtetoj faktin nëse të njëjtës i takon kompensimi sipas vendimit të lartcekur.

Po ashtu, Gjykata e Apelit nuk e pranoj si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vendimit për gjykimin e kamatës ligjore për paditësit, përkatësisht llogaritjes së kamatës së arritshme për shujta dhe kualifikim, pasi që e njëjta nuk është gjykuar në përputhje me nenin 382 të LMD-së, pasi që duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të nxjerr nga Gjykata Supreme e Kosovës, parashihet që pavarësisht kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet që t'i eliminojë shkeljet e konstatuara si më lartë, të mbajt shqyrtim gjyqësor në mënyrë që të vërtetoj gjendjen faktike sa i përket licencimit të paditëses së parë, duke vërtetuar kështu nëse e njëjta ka bazë ligjore për përfitimin e ngritjes së pagës bazë, dhe pas eliminimit të këtyre dilemave të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me nenin 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitivi të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.6748/2022, me datë 07.02.2024

Kryetarja e kolegjit  
Naime Ahmeti d.v